VENDIM
Nr. 346, datë 29.4.2015

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për bashkëpunimin ekonomik, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK

Hyrje

Duke pasur parasysh që Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi (më poshtë referuar si "Palët Kontraktuese");

Duke dashur të zgjerojnë marrëdhëniet e ndërsjella në fushën e bashkëpunimit ekonomik dhe teknik mbi një bazë të qëndrueshme dhe afatgjatë;

Konfirmojnë interesin e tyre në forcimin e bashkëpunimit;

kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1
Objekti i marrëveshjes

1.1 Objekti i Marrëveshjes është të nxisë zhvillimin e bashkëpunimit në sferën e fushave ekonomike dhe teknike bazuar mbi barazinë dhe përfitimet e ndërsjella në përputhje me legjisla-cionet përkatëse në të dy shtetet.

1.2 Bashkëpunimi do të përfshijë, por jo me kufizim, fushat e mëposhtme:

1. Industri;
2. Energji;
3. Tregti në mallra dhe shërbime;
4. Bujqësi;
5. Mjedis;
6. Turizëm;
7. Transport;
8. Fusha të tjera të bashkëpunimit ekonomik, teknik dhe tregtar për të cilat mund të bihet dakord reciprokisht.

1.3 Me qëllim zbatimin e bashkëpunimit ekonomik, tregtar dhe teknik, në termat e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të inkurajojnë subjektet përkatëse të specializuara dhe sektorin privat për të eksploruar mundësitë e zbatimit të projekteve në fusha të ndryshme të bashkëpunimit ekonomik.

Neni 2

Detyrimet e Palëve Kontraktuese

2.1 Palët Kontraktuese:

2.1.1 duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik, teknik dhe tregtar në të dy shtetet;

2.1.2 duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për shkëmbimin e informacioneve në lidhje me situatën ekonomike në të dy shtetet mbi rregulloret, programet ekonomike, biznesin dhe informacione të tjera të interesit të përbashkët;

2.1.3 duhet të identifikojnë problemet, që pengojnë tregtinë dypalëshe, bashkëpunimin teknik dhe ekonomik, dhe të propozojë masa për zgjidhjen e këtyre problemeve.

2.2 Palët Kontraktuese:

2.2.1 duhet të nxisin pjesëmarrjen e personave fizike dhe juridikë dhe sektorët privatë të të dyja shteteve në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare, që do të zhvillohen në të dyja shtetet;

2.2.2 duhet të mbështesin dhe inkurajojnë shkëmbimin e vizitave të delegacioneve tregtare;

2.2.3 duhet të mbështesin hapjen e zyrave përfaqësuese dhe degëve të shoqërive nga njëra Palë Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 3

Krijimi i një komisioni të përbashkët ekonomik

3.1 Një komision i përbashkët ekonomik që përbëhet nga përfaqësues të të dy Palëve Kontraktuese, dhe ku është e nevojshme, me përfaqësues të institucioneve të sektorit publik ose privat do të krijohet për të koordinuar dhe promovuar bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe teknik të identifikuar sipas nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje me:

3.1.1 ndjekjen e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje;

3.1.2 zhvillimin e bashkëpunimit në fushat e parashikuara në këtë Marrëveshje ose ndryshe të rëna dakord më pas ndërmjet Palëve Kontraktuese;

3.1.3 identifikimin e kufizimeve dhe propozimi i zgjidhjeve për kapërcimin e tyre.

3.2 Komisioni i Përbashkët Ekonomik do të mblidhet sipas nevojës, në mënyrë alternative në të dy vendet me kërkesë të njërës Palë Kontraktuese dhe me pranimin e Palës tjetër Kontraktuese.

3.3 Secila Palë Kontraktuese do të caktojë një kryetar nga ana e saj (referuar si "Bashkëkryetar ") dhe secili bashkëkryetar do të caktojë një Sekretariat për pjesën përkatëse të Komisionit.

3.4 Pala Kontraktuese pritëse, sekretariati i së cilës do të jetë përgjegjës për përgatitjen e procesverbalit, do të propozojë datën dhe agjendën e mbledhjes.

3.5 Për diskutimin e çështjeve të veçanta, Komisioni mund të vendosë të krijojë grupe pune dhe të specifikojë detyrat e tyre.

3.6 Secila Palë Kontraktuese do të marrë përsipër koston e delegacioneve të saj në mbledhjet e Komisionit të Përbashkët Ekonomik.

3.7 Rregullimet e rekomanduara nga Komisioni i Përbashkët Ekonomik për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të lidhen në përputhje me kërkesat e brendshme të të dyja Palëve Kontraktuese.

Neni 4

Marrëveshjet rajonale dhe ndërkombëtare

4.1 Kjo Marrëveshje:

4.1.1 nuk do të cenojë të drejtat dhe detyrimet e Marrëveshjeve të tjera në fuqi, të lidhura nga Republika e Shqipërisë ose Mali i Zi me palët e treta, si dhe të drejtat dhe detyrimet që lindin nga

anëtarësimi i të dy shteteve në organizata rajonale dhe ndërkombëtare, të tilla si OBT apo anëtarësime të ardhshme të Palëve Kontraktuese në BE;

4.1.2 dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohen ose zbatohen në një mënyrë të tillë që të anulojnë ose përndryshe të cenojnë detyrimet sipas Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe Komunitetit Europian.

Neni 5

Interpretimet dhe zgjidhja e konflikteve

Çdo konflikt ndërmjet Palëve Kontraktuese që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve dhe protokolleve shtesë, do të zgjidhet miqësisht përmes konsultimeve ose negociatave ndërmjet zyrtarëve të Komisionit të Përbashkët Ekonomik , dhe nëse kjo dështon, çështja e konfliktit ose interpretimit do të zgjidhet përmes kanaleve diplomatike dhe konsultimeve dhe do të zhvillohet menjëherë me kërkesë të njërës prej Palëve Kontraktuese.

Neni 6

Ndryshimet

Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen me miratimin e ndërsjellë të Palëve Kontraktuese, me shkrim. Ndryshime dhe shtesa të tilla do të bëhen në formën e protokolleve të ndara që janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe do të hyjnë në fuqi pas miratimit të dhënë nga Palët Kontraktuese.

Neni 7

Kohëzgjatja, rinovimi dhe anulimi

7.1 Secila Palë Kontraktuese do të njoftojë me shkrim Palën tjetër Kontraktuese në lidhje me përfundimin e procedurave të brendshme të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e fundit të këtyre njoftimeve.

7.2 Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë prej pesë vitesh dhe do të rinovohet automatikisht për një periudhë të njëjtë përveç nëse njëra Palë Kontraktuese njofton Palën tjetër Kontraktuese për dëshirën e saj për ta përfunduar atë, me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, brenda të paktën gjashtë muajsh para mbarimit të saj.

7.3 Njoftimi i përfundimit do të hyjë në fuqi një vit pas marrjes nga Pala tjetër Kontraktuese.

7.4 Në rast të njoftimit për të përfunduar këtë Marrëveshje, përveç nëse Palët Kontraktuese kanë rënë dakord ndryshe, angazhimet që rrjedhin nga kontratat e lidhura sipas dispozitave të saj dhe që nuk janë zbatuar ende do të jenë të vlefshme derisa këto kontrata të zbatohen plotësisht.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit e autorizuar rregullisht për këtë qëllim nga qeveritë e tyre respektive kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Tiranë , më 23 shkurt 20l5, në dy tekste origjinale, në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze, duke qenë të gjitha tekstet njëlloj autentike. Në rast mosmarrëveshje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.